



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**), nenit 51, paragrafi 51.1 dhe nenit 52 të Ligjit nr. 03/L– 40, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), të dispozitave të neneve 3, 4, 5 dhe nenit 6, të Udhëzimit administrativ nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve të tjera në komunë, të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d**) dhe të nenit 44, paragrafi 44.1, shkronja **a**) të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 27.2.2026, merr këtë:

VENDIM
PËR
FORMIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

I. Miratohet- Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si komitet i përhershëm.

II. Komiteti për Politikë dhe Financa ka këtë përbërje:

- 1. Fehmi Kupina- kryesues;**
- 2. Jeta Rafuna nga LDK, anëtare;**
- 3. Dhurata Jahaj-Retkoceri nga LDK, anëtare;**
- 4. Amir Simnica nga LDK, anëtar;**
- 5. Leutrim Retkoceri nga PDK, anëtar;**
- 6. Fjolla Vukshinaj-Reçica nga PDK, anëtare;**
- 7. Agron Canolli nga PDK, anëtar;**
- 8. Nora Kelmendi nga LVV, anëtare;**
- 9. Gëzim Sveçla nga LVV, anëtar;**
- 10. Kreshnik Smajlaj nga AAK, anëtar;**
- 11. Arbenita Murseli-Haxholli nga Lidhja e Prishtinës, anëtare.**

III. Komiteti si në pikën I të këtij vendimi, është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, si dhe dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

KUVENDI I KYEQYTETIT
01-020/04-31224/26, më 2.3.2026

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

